

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
MISIONI NË KOSOVË**

Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës

**SFIDAT E TË DREJTAVE TË NJERIUT
Pas trazirave të muajit mars**

PËRMBAJTJA

SIGURIA	6
1.1. Hyrje	6
1.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut	6
1.2.1 Shqetësimet lidhur me sigurinë e pakicave në të ardhmen	6
1.2.2 Shqetësimet lidhur me plotësinë dhe paanshmërinë e hetimeve të veprave penale.	7
1.2.3 Shqetësimet lidhur me plotësinë dhe paanshmërinë e policisë së UNMIK-ut në hetimet e kontrollit të brenshëm dhe hetimet e njësisë së SHPK-së për standardet profesionale.	8
1.2.4 Ndikimet në tranzicionin e Shërbimit Policor të Kosovës.....	8
1.2.5 Ndikimet në zbatimin e Kodit të përkohshëm penal dhe të procedurës penale	9
QASJA NË DREJTËSI	9
2.1 Hyrje	10
2.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut	10
2.2.1 Mundësitë e banorëve të Kosovës nga komunitetet e pakicave për të pasur qasje fizike nëpër gjykata për t'i shqyrtuar problemet e tyre ligjore	10
2.2.2 Mundësitë e personelit gjyqësor nga komunitetet e pakicave që të kenë qasje në vendet e tyre të punës.....	10
2.3 Hapat e ndërmarrë nga UNMIK-u për adresimin e problemeve	11
2.4 Aktivitetet përcjellëse	11
MONITORIMI I SISTEMIT JURIDIK	11
3.1 Hyrje	12
3.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut	12
3.2.1 Perceptimi lidhur me animin e gjyqtarëve shqiptarë të Kosovës.....	12
3.2.2 Mbrojtja e dëshmitarëve/frikësimi	12
3.2.3 Presioni mbi gjyqtarët dhe prokurorët vendës.....	13
3.2.4 Aftësia e sistemit gjyqësor për t'u përballur me influksin e lëndëve.....	13
3.2.5 Çështjet që kanë të bëjnë me paraburgimin.....	13
3.2.6 Burgjet e stërmbushura	14
3.2.7 Zbatimi i Kodit të përkohshëm penal dhe Kodit të procedurës penale	14
3.3 Veprimet e Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut dhe gjyqësisë vendëse	14
3.4 Aktivitetet përcjellëse	14
TË DREJTAT PRONËSORE	15
4.1. Hyrje	15
4.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut	15
4.2.1 Ndarja e banimeve të përkohshme për personat e zhvendosur.....	16
4.2.2 Rindërtimi	17
4.2.3 Okupimet e reja të kundërligjshme	19
MOS DISKRIMINIMI	21
5.1 Hyrje.....	21
5.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut	21
5.2.1 Qasja në shkollimin fillor dhe të mesëm për nxënësit nga komunitetet e pakicave	21
5.2.2 Qasja në mirëqenien sociale për komunitetet e pakicave	22
5.2.3 Qasja në kujdesin shëndetësor për të zhvendosurit dhe komunitetet e pakicave që kanë mbetur në lokalitetet e prekura nga ngjarjet e marsit	22
5.2.4 Qasja në vendet e punës për komunitetet e pakicave.....	23
5.2.5 Qasja në shërbimet publike për komunitetet e pakicave.....	23
5.2.6 Mosrespektimi i standardeve për përdorimin e gjuhëve zyrtare nga ana e autoriteteve komunale dhe qendrore.....	23
5.2.7 Ndarja e drejtë e granteve për komunitetet e pakicave përmes financimit të barabartë komunal.....	23
5.3 Veprimet e ndërmarrë nga UNMIK-u dhe IPVQ-të për adresimin e shqetësimeve	24
5.3.1 Qasja në vendet e punës për komunitetet e pakicave.....	24
5.3.2 Mosrespektimi i standardeve për përdorimin e gjuhëve zyrtare nga ana e autoriteteve qendrore dhe komunale.....	24
5.4 Aktivitetet përcjellëse	25

FJALORI

COMKFOR	Komandati i KFOR-it
ORMK	Organi rishqyrtues për meanxhimin e krizave
QPS	Qendra për Punë Sociale
KKPB	Komisioni për kërkesa pronësore dhe banesore
DÇPB	Drejtoria për çështje pronësore dhe banesore
KMDNj	Komiteti i mbikqyrjes së të drejtave të njeriut
PNDESK	Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
PZH	Personat e zhvendosur
GPNDNj	Grupi punues ndërshtyllor mbi të drejtat e njeriut
SIGj	Seksioni për integrim gjyqësor
BKK	Bugjeti i konsoliduar i Kosovës
KFOR	Forcat e Kosovës
KFOR FRAGO	Rendi (urdhëri) fragmentues i KFOR-it
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
ZKL	Zyra e komunitetit lokal
ZKK	Zyra e komunitetit komunal
ZMK	Zyra për marrëdhënie të komunitetit
OMiK	Misioni i OSBE-së në Kosovë
ORC(orig)	Zyra për kthime dhe komunitete
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim evropian
IPV	Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes
PSSP	Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm
UNHCR	Komisioneri i lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatë
UNMIK në Kosovë	Misioni i administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara
KSKB	Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

HYRJE

Filloi me 17 mars me diçka që dukej si demonstratë paqësore. Mësuesit i udhëhoqën nxënësit e tyre për në urën e cila e lidhë veriun dhe jugun e Mitrovicës/Mitrovica, për të protestuar kundër vdekjes së tre fëmijëve shqiptarë nga Kosova të cilët siç pohohej ishin ndjekur për në lumin Ibër nga serbët e Kosovës të cilët ua kishin vërsulur qentë. Tre orë më vonë, gjashtë persona ishin vrarë ndërsa anekënd Kosovës shtëpitë ishin vënë në flakë nga protestuesit e zemëruar. Fushata e spastrimit etnik kishte zgjatur tre ditë dhe kishte lënë mbas 19 të vrarë, 954 të lënduar, 4100 të zhvendosur, 550 shtëpi dhe 27 kisha dhe manastire ortodokse të djegura dhe 182 shtëpi dhe kisha/manastire tjera të dëmtuara.

Menjëherë pas dhunës, Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka ndërmarrë një program të monitorimit për qëllim të pasqyrimin të shkeljeve të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur, e që ndërliidhen me dhunën, përfshirë këtu edhe reagimin (apo mungesën e tij) e autoriteteve gjegjëse.¹ Pas trazirave janë kristalizuar një numër sfidash për të drejtat e njeriut.

Ky dokument nuk përmbanë analiza të hollësishme, ose kategorizime të shkeljeve ndaj të drejtave të njeriut që kanë ndodhur gjatë 17-20 marsit. Ngjarjet e marsit na i kanë përkujtuar sulmet e gjëra dhe të dhunshme të motivuara mbi bazat etnike të kryera veçanërisht kundër serbëve dhe romëve të Kosovës gjatë verës së vitit 1999. Në atë kohë nuk kishte struktura të themeluara për t'u marrë me këto stida. Ishte detyrë e OmiK-ut për të raportuar hollësisht mbi këto ngjarje.

Sot, pas pesë vitesh, institucionet janë të themeluara. Këto institucione, çofshin ato ndërkombëtare apo të vendit, kanë obligime ligjore që të ballafaqohen me sfidat e reja. OmiK-u to t'i zotojë resurset e veta për t'i ndihmuar këto institucione në menaxhimin e spektrit të gjërë të problemeve lidhur me të drejtat e njeriut që kanë rezultuar nga ngjarjet e marsit; përmes aktiviteteve afatshkurta të monitorimit dhe aktiviteteve afatgjata të ndërtimit të kapaciteteve dhe këshillëdhënjes.

Qëllim i këtij dokumenti është që ta bëjë punën OmiK-ut në sferën e të drejtave të njeriut më transparente. Ky dokument i nënvizon, aty për aty, problemet lidhur me të drejtat e njeriut që kanë buruar si rezultat i dhunës – për autoritetet përgjegjëse si dhe për opinionin e gjërë. Ky mund të shihet si një indikator i hershëm i paralajmërimit. Autoritetet përgjegjëse duhet që t'i identifikojë sa më heret problemet, në mënyrë që të sigurojë se spastrimi etnik (ose përpjekja) nuk shpaguhet.

E drejta ndërkombëtare i obligon organet shtetërore që t'i mbrojnë nga dhuna banorët dhe pronën e tyre.² Për më shumë, sipas ligjit vendës, autoritete shtetërore mbajnë përgjegjësinë për humbjen për shkak të vdekjes, ose lëndimit trupor dhe dëmit pasuror të shkaktuar nga aktet e dhunës gjatë demonstratave në rrugë dhe ngjarjeve publike.³

OmiK-u do të punojë me autoritetet përgjegjëse për të siguruar se reagimi ndaj ngjarjeve të marsit të bëhet tërësisht në pajtim me të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës. UNMIK-u ka obligim ligjor të merr përsipër përgjegjësinë për dështimin e organeve të veta të zbatimit të

¹ Prej 23 deri me 26 mars, oficerët e të drejtave të njeriut të OmiK-ut i kanë intervistuar përafërsisht 100 viktimat ose dëshmitarë të dhunës.

² Shih nenin 1, Protokolin 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut..

³ Shih nenin 180, të Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore. Standardet ndërkombëtare gjithashtu kërkojnë nga autoritetet shtetërore që të përpiqen t'i krijojnë procedurat efikase dhe strukturat për t'ju përgjigjur nevojave të viktimave, siç janë, qasja në drejtësi dhe dëmshtëpërlimi. Për shembull shih Deklaratën e principeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit, Rezoluata e Asamblesë së Përgjithshme 40/34, datë 29 nëntor 1985.

ligjit, dhe duhet që shpejtë dhe në mënyrë të hollësishme t'i hulumtojnë dhe ndjekë penalisht krimet e kryera në ndërlidhje me dhunën.⁴ KFOR-i duhet t'i shqyrtojë reagimet e veta gjatë dhunës me për të parë nëse kanë ekzistuar probleme të natyrës organizative ose operacionale.

Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (IPVQ) e në veçanti komunat duhet që në mënyrë proaktive të ofrojnë shërbimet themelore siç janë, arsimimi dhe shëndetësia, për të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet e pakicave nuk do të duhej të mbështeteshin në shërbimet e ofruara nga strukturat paralele. IPVQ duhet të marrin përgjegjësitë e plota të pushtetit ekzekutive sipas Kornizës Kushtetuese⁵ dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19⁶ dhe të funksionojnë në atë mënyrë që strukturat paralele të bëhen të panevojshme.

Një gjë mund të konstatohet. Të gjitha autoritetet përgjegjëse kanë dështuar në një masë të madhe. Pasojat e tmerrshme të ngjarjeve të marsit flasin për vete. Nuk ka vend për arsytetime: mirëpo ekziston hapësirë e mjaftueshme për përmirësime. Përmirësimet mund të arrihen vetëm përmes të kuptuarit të plotë dhe të përbashkët të problemeve dhe sfidave.

OmiK-u nuk dëshiron të diktojë sjellje të caktuara dhe të propozojë rrugëdaljen nga kjo gjendje e mjerë. Mënyra e ecjes përpara duhet të gjindet në partneritet me akterët vendës dhe ata ndërkombëtarë. Për hir të efikasitetit dhe për hir të njerëzve të Kosovës, sfidat e përmendura në këtë dokument duhet të adresohen nga ana e autoriteteve përgjegjëse. IPVQ dhe UNMIK-u në kuadër të projektimit dhe zbatimit të programeve të tyre si reagim ndaj dhunës, duhet të bartin porosinë e qartë se dhuna etnike është e papranueshme në shoqërinë demokratike.

⁴ Sipas standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, atëherë kur ndodhë dhuna, autoritetet shtetërore kanë për obligim që t'i hulumtojnë dhe ndjekin penalisht personat e përgjegjshëm. Shih nenin 3 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas interpretimit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. P.sh, rasti *Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 13134/87, 25 march 1993, *A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 25599/94, 23 shtator 1998, *Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, nr. 29392/95, të datës 10 maj 2001, dhe *X dhe Y kundër Holandës*, 8978/80, 26 mars 1985.

⁵ Rregullrja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuse për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 mbi degën e ekzekutivit për Institucionet të Përkohshme të Vetëqeverisjes.

SIGURIA

1.1. Hyrje

Në përgjigjen e menjëhershme ndaj ngjarjeve të 17-19 marsit, KFOR-i, policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) kanë shfaqur zbrastësira serioze në aftësitë e tyre për të vënë nën kontrollë, për ta përmbajtur dhunën dhe për ta mbrojtur sigurinë e pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave.

Në bazë të nenit 28 të Deklaratës Universale për të drejtat e njeriut “çdo njeri ka të drejtën që, në planin shoqëror dhe ndërkombëtar, të mbretërojë një rend i tillë ku të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë të mund të gjejnë realizim të plotë”. KFOR-i, policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja duhet ta kenë rolin e arritjes së këtij rendi shoqëror dhe ndërkombëtar për qytetarët e Kosovës duke i mbrojtur të drejtat e njeriut të të gjithë qytetarëve prej shkeljeve nga të tjerët dhe duke respektuar të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të detyrave të veta. Seksioni i OmiK-ut për monitorimin e sigurisë në Kosovë, kryesisht fokusohet në aktivitetet e policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së, ndërsa pas ngjarjeve të 17-19 marsit, si sfidë është paraqitur përkrahja e zhvillimit të një shërbimi policor efektiv, të përgjegjshëm dhe në përputhje me të drejtat e njeriut, e i cili do të ketë besimin dhe përkrahjen nga pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike në Kosovë.

Mirëpo, ngjarjet e 17-19 marsit e kanë vendosur strukturën e policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së në një pozitë të rëndë për shkak se në një anë policia e UNMIK-ut i ka përkushtuar resurset e veta në hetimin e këtyre ngjarjeve ndërsa në të njëjtën kohë bënë përpjekje për kryerjen e funksioneve themelore policore, për vazhdimin e kalimit të përgjegjësive tek SHPK-ja, dhe për përshtatjen e rregullave dhe procedurave të veta në harmoni me kërkesat e dy kodeve të tani rishtasi kanë hyrë në fuqi, respektivisht Kodit të përkohshëm penal dhe Kodit të përkohshëm të procedurës penale.⁷

1.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut

1.2.1 Çështjet lidhur me sigurinë e pakicave në të ardhmen

Ngjarjet e 17-19 marsit i kanë kufizuar rëndë mundësitë e pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave për të jetuar, udhëtuar dhe punuar në Kosovë, dhe e kanë dëmtuar besimin e tyre në aftësitë e KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së për ruajtjen e sigurisë dhe kryerjen efikase të detyrave policore.

Për këtë arsye nevojiten masa plotësuese me qëllim të rindërtimit të besimit dhe të përmirësimit të sigurisë për pakicat. Në këtë drejtim, OmiK-u i përhëndetë zotimet e përbashkëta që i kanë marrë komandanti i Brigadës Shumëkombëshe Qendër dhe komandanti i regjionit të Prishtinës/Priština i policisë së UNMIK-ut për të ...”zhvilluar trajnime dhe operacione të përbashkëta dhe për të krijuar një komandim efektiv dhe sistem efikas të kontrollit, kështu që bashkarisht të mund të luftohet çfarëdo situatë që del ballë”⁸ Mirëpo, është për të ardhur keq që ky zotim është bërë vetëm pas ngjarjeve të 17-19 marsit. Që nga 15 maji 2002, COMKFOR-i ka urdhëruar (si një gurëthemel i strategjisë së tranzicionit të sigurisë KFOR/UNMIK⁹) që “Komandantët duhet të zhvillojnë trajnime të përbashkëta me

⁷ Rregulloret e UNMIK-ut 2003/25 dhe 2003/26

⁸ Artikulli i gazetës (*Epoka e Re*) Prishtinë, 16 prill 2004.

⁹ 29 maj 2002, shtojca B e KFOR FRAGO 1285.

*personelin e policisë së UNMIK-ut për qëllim të përgatitjes më të mirë për përgjigje të duhura dhe koherente ndaj kërcënimeve të caktuara të sigurisë*¹⁰. Nga kjo, është e qartë se ka munguar një përgjigje koherente dhe e përshtatshme me 17-19 mars 2004.

Megjithatë, shumë prej personave të zhvendosur që i ka intervistuar OmiK-u menjëherë pas dhunës, kanë treguar për vendosshmërinë e tyre për të qëndruar në Kosvoë dhe për t'i rimarrë dhe rindërtuar shtëpitë e tyre nëse jepet mbrojtje e duhur nga ana e KFOR-it.

Mirëpo, përderisa prania e shtuar e KFOR-it është padyshim e nevojshme se kundërpërgjigje ndaj ngjarjeve të marsit, prap kjo nuk mund të ofrojë një zgjidhje permanente dhe të qëndrueshme për sigurinë e pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave. UNMIK-u dhe IPVQ duhet t'i nënvizojnë dhe adresojnë shkaqet kryesore të dhunës me qëllim të krijimit të kushteve në të cilat siguria dhe mbrojtja për pakicat do të ofroheshin në kuadër të aktiviteteve normale policore të UNMIK-ut ose eventualisht të SHPK-së shumetnike.

OmiK-u do të monitorojë, në kuadër të aktiviteteve të veta, edhe zbatimin strategjive të KFOR-it për ofrimin e sigurisë për komunitetet e pakicave, si dhe raportin në mes të KFOR-it dhe strategjive të policisë së UNMIK-ut/SHPK-së në këtë drejtim, përfshirë edhe zbatimin e strategjisë së tranzicionit të sigurisë - KFOR/UNMIK¹¹.

1.2.2 Shqetësimet lidhur me plotësinë dhe paanshmërinë e hetimeve të veprave penale.

Karakteri etnik i dhunës si dhe pohimet se disa individë shqiptarë të Kosovës nga radhët e SHPK-së kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në këto trazira (ose se nuk i kanë parandaluar sulmet)¹² mund të ngrisin shqetësimet në radhët e pakicave se hetimet policore kundër kryesve të dyshuar do të dështojnë në rast se marrin pjesë në to oficerët e SHPK-së.

Në lidhje me zhvillimin e hetimeve, policia e UNMIK-ut ka njoftuar për krijimin e ekipeve të veçanta hetimore në nivelin qendror për të hulumtuar veprat penale të kryera gjatë 17-19 marsit.¹³ Komisioneri i policisë së UNMIK-ut e ka njoftuar OmiK-un për masat që janë ndërmarrë për sigurimin e vazhdimësisës së funksioneve themelore policore, për rekrutimin e një numri plotësues të hetueseve policor të UNMIK-ut dhe caktimin e prioriteteve të hulumtimit/hetimit. Mirëpo këto masa nuk i adresojnë drejtpërdrejtë shqetësimet e komuniteteve të pakicave lidhur me paanshmërinë e hetimeve. Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja kanë nevojë të marrin hapa për t'i siguruar komunitetet e pakicave se masat e ndërmarra do ta ruajnë integritetin e hetimeve policore, njokohësisht se do të sigurojnë mbrojtjen e atyre dëshmitarëve deklaratat e të cilëve janë duke u shqyrtuar nga hetuesit policor.

OmiK-u nuk e ka mandatin e monitorimit të zhvillimit të hetimeve policore në mënyrë të drejtpërdrejtë, por këto çështje do t'i ngritë para Shtyllës I të UNMIK-ut (Policë dhe Drejtësi) për shkak se ato paraqiten gjatë programeve rrjedhëse të monitorimit të të drejtave të njeriut.

¹⁰ HQKFOR COMKFOR urdhëri 25: Bashkëpunimi me policinë e UNMIK-ut, 15 maj 2002.

¹¹ Strategjia e sigurisë e KFOR-it/UNMIK-ut, e nënshkruar me 29 maj 2002, i përcakton parimet e përbashkëta të KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut me qëllim të caktimit të përgjegjësisë për detyrat e sigurisë që duhet t'i barten policisë së UNMIK-ut.

¹² Këto pohime i janë bërë oficerëve për të drejtat e njeriut të OmiK-ut gjatë intervistave me të zhvendosurit gjatë 23 dhe 26 marsit. Me pajtimin e të intervistuarve këto pohime i janë bartur policisë së UNMIK-ut për t'u hetuar. Duhet të përmendet se të zhvendosurit kishin përmendur edhe raste kur oficerët shqiptarë dhe serb të Kosovës të SHPK-së, i kishin kryer detyrat e tyre në mënyrë të rregullt dhe efikase gjatë dhunës.

¹³ Shënimet nga njoftimi i policisë së UNMIK-ut, më 31 mars 2004.

1.2.3 Shqetësimet lidhur me plotësinë dhe paanshmërinë e policisë së UNMIK-ut në hetimet e kontrollit të brendshëm dhe hetimet e njësisë së SHPK-së për standardet profesionale.

Për ruajtjen e besimit në përgjegjësitë e SHPK-së është esenciale që të gjitha pohimet lidhur me veprat penale, shkeljet e rregullave dhe procedurës (përfshirë edhe shkeljet e standardeve për të drejtat e njeriut) nga ana e oficerëve të SHPK-së gjatë ngjarjeve të 17-19 marsit të hulumtohen dhe hetohen plotësisht.

Momentalisht OmiK-u është duke monitoruar aspektet procedurale të hetimeve të kontrollit të brendshëm të UNMIK-ut dhe hetimeve në lidhje me standardet profesionale të SHPK-së dhe raportin e vet do ta prezantojë para grupit punues ndërshtyllor mbi të drejtat e njeriut¹⁴ aty ka fundi i muajit korrik.

Mirëpo, ndërkohë OmiK-u rekomandon që policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja të marrin hapa drejt sigurimit se komunitetet e pakicave dhe në veçanti ata persona të cilët janë ankuar për sjellje të pahijshme policore gjatë dhunës së marsit, të mbahen të informuar plotësisht lidhur me progresin dhe rezultatin e këtyre hetimeve.

1.2.4 Ndikimet në tranzicionin e Shërbimit Policor të Kosovës

Zhvillimi afatgjatë i shërbimeve policore në Kosovë varet nga zhvillimi i SHPK-së efektive. Ngjarjet e mesit të marsit, si dhe pohimet e mëpastajme lidhur me individë në kuadër të SHPK-së lidhur me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë ose duke e luajtur rolin e vëzhguesit pasiv ndaj dhunës me motive etnike,¹⁵ ka gjasa se do të ndikojë në procesin e policisë së UNMIK-ut për tranzicionin (bartjen) e stacioneve policore nën komandën dhe kontrollin e SHPK-së. OmiK-u është njoftuar edhe se shkalla e besimit në radhët e oficerëve serbë të Kosovës në SHPK është mjaft e ultë si pasojë e dështimit të KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe kolegëve të tyre shqiptarë nga SHPK-ja për t'i mbrojtur ata dhe komunitetet e tyre.

Si një prej shembujve të dukshëm është ai i serbëve të Kosovës, oficerë të SHPK-së të angazhuar në stacionin policor të Shtërpcës/Štrpce, të cilët pas trazirave kanë refuzuar të kthehen në punë dhe të punojnë bashkarisht me kolegët e tyre shqiptarë. Oficerët serbë të SHPK-së kanë filluar me detyrat e tyre vetëm pasi janë paralajmëruar se do të suspendohen nëse nuk i respektojnë urdhërat.

OmiK-u do të vazhdojë të përcjellë efektet e dhunës në funksionimin e shërbimit shumetnik policor në Kosovë.

Në një kontekst më të gjërë, policia e UNMIK-ut e ka njoftuar OmiK-un se procesi i kalimit të stacioneve policore nën kontrollin e SHPK-së është ngrirë në pritje të një procesi të rishqyrtimit dhe planifikimit strategjik i cili do të merr parasyshë ngjarjet e 17-19 marsit. Nga OmiK-u është kërkuar që të ofrojë elementet e të drejtave të njeriut në këtë rishqyrtim dhe të vazhdojë punën në partneritet me policinë e UNMIK-ut në kuadër të mandatit që e ka OmiK_u për të ndihmuar dhe zhvilluar një shërbim policor i cili është efikas, i përgjegjshëm, dhe në pajtim me të drejtat e njeriut.

¹⁴ Grupi punues ndërshtyllor mbi të drejtat e njeriut është krijuar në vitin 2002 në rolin e një mekanizmi të brendshëm të UNMIK-ut për monitorimin e të drejtave të njeriut. I përgjigjet Komitetit të lartë mbiqyrës për të drejtat e njeriut i cili ka për mandat të shqyrtojë dhe të jepë pajtimin për akcionet dhe politikat e fuqizimit të mbrojtjes për të drejtat e njeriut në Kosovë.

¹⁵ Shih fusnotën 12 *supra*.

1.2.5 Ndikimet në zbatimin e Kodit të përkohshëm penal dhe Kodit të procedurës penale

Kodi i ri penal dhe Kodi i procedurës penale kanë hyrë në fuqi më 6 prill 2004, vetëm tre javë pas dhunës.¹⁶

Kodet e reja parashikojnë kornizën e reviduar të përgjegjësive të policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së për zhvillimin e hetimeve. Tani prokurori publik mbanë autorizimet mbi “policinë gjyqësore”, e cila është e autorizuar të zhvillojë hetime të veçanta (p.sh., operacionet e hetimeve të fshehta). Disa oficerë nga radhët e policisë së rregullt tani janë caktuar si “policë gjyqësorë”. Kodi parashikon edhe afatet kohore të reviduara si dhe procedurën e arrestimit policor, paraburgimit dhe marrjes në pyetje.

OmiK-u është i brengosur për faktin se dhuna e marsit ka mundur t'i pengojë trajnimet përfundimtare dhe përgatitjet e policisë për zbatimin e këtyre kodeve dhe se të drejtat e personave të arrestuar të parashikuara me këto kode mund të mos respektohen si duhet.

OmiK-u do të vazhdojë sidoçoftë me programet e veta të monitorimit të të drejtave të personave të arrestuar me qëllim të vlerësimit të vetëdijësimit të policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së lidhur me zbatimin e pjesëve relevante të kodeve të reja.

Në këtë kontekst, OmiK-u gjithashtu është i shqetësuar lidhur me mungesën e vazhdueshme të dokumentacionit të standardizuar – “njoftimi i të drejtave”- dhe të shënimeve për mbajtjen e personave nën arrest nga policia. Gjatë muajve që kanë shpër në shpalljen në fuqi të kodeve të reja, OmiK-u ka marrë pjesë në grupin punues, të cilin e ka formuar komisioneri i policisë së UNMIK-ut dhe që është kryesuar nga shefi i seksionit juridik të policisë së UNMIK-ut, i cili grup ka pasur për detyrë ta përpilojë dokumentacionin e standardizuar i cili do të ishte në përputhje me Kodin e ri të procedurës penale. Dokumentet e përpiluara nga grupi punues nuk i kishte miratuar (e as shpërndarë brenda) policia e UNMIK-ut dhe SHPK-së. Për më shumë, OmiK-u tani është njoftuar për dokumentacionin alternativ, i cili nuk është miratuar nga shtabi qendror i policisë së UNMIK-ut, i cili ishte shpërndarë nga prokurorët ndërkombëtarë nëpër stacionet policore të regjioneve të Pejës/Peç dhe Gjilanit/Gnjilane.

Në mungesë të përkohshme në shefit të seksionit juridik të policisë së UNMIK-ut, OmiK-u nuk ka pasur mundësi të sigurojë sqarime lidhur me gjëndjen e dokumentacionit të hartuar nga grupi punues. Për shkak se qëllimi i angazhimit të OmiK-ut në procesin e hartimit ishte të sigurojë marrjen parasysh të të drejtave të personave të arrestuar, OmiK-u do të vazhdojë të ndikojë që dokumentacioni i duhur të shpërndahet si në kuadër të policisë së UNMIK-ut poashtu edhe në SHPK.

QASJA NË DREJTËSI

¹⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 dhe 2003/26.

2.1. Hyrje

Çështja e sigurimit të qasjes në drejtësi ka qenë një sfidë e vazhdueshme për autoritetet e Kosovës gjatë viteve të fundit¹⁷, ndërsa ngjarjet e marsit si rrjedhojë kanë pasur ndërlikimin e mëtutjeshëm të kësaj gjendjeje. Së pari, mundësia e banorëve të Kosovës nga radhët e komuniteteve të pakicave që të kenë qasje fizike nëpër gjykata për t'i adresuar problemet specifike ligjore është komplikuar edhe më shumë. Së dyti, personeli gjyqësor nga pakicat – përfshirë gjyqtarët, prokurorët dhe personelin ndihmës – kanë hasur në vështirësi plotësuese kur është fjala te qasja në gjykata si të punësuar.

2.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut

2.2.1 Mundësia e banorëve të Kosovës nga komuniteteve të pakicave për të pasur qasje fizike në gjykata për t'i shqyrtuar problemet e tyre ligjore

Qysh edhe para trazirave të marsit, qasja në gjykata për pjesëtarët e komuniteteve të pakicave ka qenë çështje e komplikuar. Pjesëtarët e pakicave të cilët duhet të shkojnë në gjykata shpeshherë ballafaqohen me vështirësi për ta organizuar udhëtimin. Në disa komunitetet siç është rasti me pjesën e epërme të Rahovecit/Orahovac, personat që kanë nevojë të shkojnë në gjykatë duhet të mbështeten në Zyrën e UNMIK-ut për komunitete lokale e cila iu ndihmon atyre të kontaktojnë stacionin policor për ta organizuar transportin. Në komunitetet tjera, Departamenti i drejtësisë i UNMIK-ut i ka organizuar zyret e ndërlidhëse me gjykatat.

Mitrovicë/Mitrovica gjithsesi paraqet probleme unike në lidhje me qasjen në drejtësi për shkak se është qytet i ndarë mbi baza etnike dhe gjykatat janë të vendosura në veri, pjesë kjo e populluar kryesisht nga serbë të Kosovës. KFOR-i e bën transportimin e personelit gjyqësor nga pjesa jugore në atë veriore tre herë në ditë, ndërsa prej veriut në jug dy herë në ditë. Ky sistem ka vepruar lehtë, përveq gjatë periudhës menjëherë pas trazirave të marsit. Në të njëjtën kohë policia e UMIK e ka vënë në veprim sistemin e transportimit të palëve dhe dëshmitarëve prej zonës së mirëbesimit për në gjykatë. Ky transport zhvillohet disa herë në ditë, por mund të ketë edhe vonesa të rastit. Ky shërbim i transportimit pas dhunës së marsit ka rifilluar të zhvillohet me 23 mars në të njëjtën ditë kur kanë rifilluar me punë edhe gjykatat. Së këndejmi përderisa KFOR dhe UNMIK-u kanë marrë masa të rregullimit të gjendjes së transportit në Mitrovicë/Mitrovica, qasja nëpër gjykata prapëprapë është e kufizuar për shkak të çështjeve të nevojshme logjistike.

Në të njëjtën kohë, ngjarjet e marsit kanë ndikuar edhe në mundësinë e gjykatave për t'i gjetur pjesëtarët e komunitetit të pakicave të cilët e kanë cilësinë e palës apo dëshmitarit. Për shembull, kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priştina, ka thënë se gjykatat nuk kanë pasur mundësi të vëjnë kontakt me serbët e zhvendosur të Kosovës, për të marrë deklaratat e tyre lidhur me ngjarjet prej 17 – 19 marsit. Duke pasë parasysh se edhe para ngjarjeve të marsit, gjetja e vendbanimit të individëve është dëshmuar të jetë sfiduese, mungesa e shënimeve se si mund të kontaktohen të zhvendosurit mund ta komplikojë edhe më tej procedurën gjyqësore dhe të shkaktojë zvarritje.

2.2.2 Mundësitë e personelit gjyqësor nga komunitetet e pakicave që të kenë qasje në vendet e tyre të punës

Gjatë dhe menjëherë pas ngjarjeve të marsit, disa gjykata janë mbyllur tërësisht për disa ditë me radhë. Të gjitha gjykatat e komunës së Mitrovicës/Mitrovica ishin mbyllur prej datës 17 deri në datën 23 mars. Gjykatat e Leposaviqit/Leposavić ishin mbyllur me 22 dhe 23 mars, përderisa ato të Zubin Potokut ishin mbyllur me 18 mars dhe ishin rihapur me 23 mars. Dega

¹⁷ Për më shumë informata, referohuni në raportin e përbashkët të OmiK-ut dhe UNHCR-së: *Vlerësimi i dhjetë i gjendjes së pakicave etnike*, mars 2003, faqe 29 – 33.

e Gjykatës Komunale të Ferizajit/Uroševac dhe Gjykata për Kundërvajtje e Shtërpcës/Štrpce ishin rihapur disa ditë pas ngjarjeve të marsit, ndërsa gjyqtarët shqiptarë të Kosovës dhe personeli ndihmës nuk ishin kthyer në punë deri më 5 prill.

Disa gjyqtarë, prokurorë dhe personel ndihmës anekënd Kosovës nuk kishin mundësi të ktheheshin në punë menjëherë pas krizës, përderisa disa punëtorë ende nuk mund të kthehen. Për shembull, katër punëtor ndihmës serb të Kosovës të punësuar në gjykatën komunale dhe kundërvajtëse të Rahovecit/Orahovac, nuk kanë mundur të lajmërohen në punë deri më 3 maj. Sipas kryetarëve të gjykatave, punëtorët ndihmës nga pakicat kanë marrë këshilla nga UNMIK-ut që të qëndrojnë në shtëpi deri në njoftimin e ardhshëm. Një prokuror serb i Kosovës, ka mbetur që të kthehet në punë në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane. Një punëtor ndihmës nga komuniteti i ashkalive ende nuk është kthyer në punë në Gjykatën për Kundërvajtje të komunës së Vushtrrisë/Vučitrn. Dy punëtorë shqiptarë të Kosovës nga Čabra/Cabra ende nuk janë lajmëruar në punë në Zubin Potok.

2.3 Hapat e ndërmarrë nga UNMIK-ut për adresimin e problemeve

Departamenti i drejtësisë pranë UNMIK-ut përmes shërbimit të integritetit gjyqësor (JIS), e ka adresuar qasjen në drejtësi dhe problemet e ndërlidhura të cilat ndikojnë në pakicat por edhe çështjen e ndihmës për personelin gjyqësor nga radhët e pakicave. Në këtë drejtim, pas ngjarjeve të marsit, JIS ka ofruar përkrahje plotësuese për zyrat ndërlidhëse me gjykatat, të vendosura në Graçanicën/Gracanica, Gorazhdevcin/Goradevac dhe Novoberdën/Novo Brdo duke ju ofruar përkrahje ligjore serbëve të zhvendosur të Kosovës. Ky shërbim gjithashtu e ka lehtësuar punën e policisë së UNMIK-ut në vlerësimin e nevojave për mbrojtje të afërt dhe transport të sigurtë për gjyqtarët dhe prokurorët serbë të Kosovës, por edhe për personelin tjetër gjyqësor. I njëjti shërbim ka shqyrtuar mundësinë e dhënjes së shërbimeve juridike pa pagesë për viktimat e dhunës së marsit.

2.4 Aktivitetet përcjellëse

OmiK-u do të vazhdojë të monitorojë çështjen e qasjes në drejtësi dhe të ofrojë përkrahje dhe/ose rekomandime sipas nevojës. Do të shiqojë më tutje edhe në çështjet: a) nëse individët nga radhët e pakicave ballafaqohen me vështirësi plotësuese në qasjen e tyre në gjykata; b) nëse personeli i gjykatave është kthyer në punë; c) nëse personelit të gjykatave i është ofruar siguria e mjaftueshme dhe transporti nga gjykatat; d) nëse gjykatave në veri i është dhënë përkrahja e duhur dhe e) nëse gjykata posedon me të dhënat e nevojshme lidhur me personat e zhvendosur anekënd Kosovës.

MONITORIMI I SISTEMIT JURIDIK

3.1. Hyrje

Në lidhje me monitorimin e sistemit drejtësisë penale, OmiK-u i ka përshatur aktivitetet e veta për t'ju dhënë prioritet lëndëve që kanë të bëjnë me shpërthimin e dhunës gjatë marsit. Sipas policisë, përafërsisht 180 arrestime janë bërë gjatë ose pas dhunës; ky numër pritet të rritet edhe më tej për shkak se KFOR-i, policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja vazhdojnë me hetimet e veta. Shumica e arrestimeve janë bërë në regjionet e Gjilanit/Gnjilane dhe Prishtinës/Priştina, përkundër faktit se në rajonet sikur ai i Prizrenit dhe Mitrovicës/Mitrovica, ka pasur çrregullime të një shkalle të gjërë.

Dhuna e mesit të muajit mars ka mundur të prodhojë efekte edhe në sistemin e drejtësisë penale dhe atë në mënyra të ndryshme. Por duhet të përmendet se shumë prej çështjeve të numëruara më poshtë paraqesin shqetësime potenciale e të cilat janë përshtirë mbi bazat e përvojës së krijuar nga monitorimet e mëhershme. Shkalla e shkeljeve aktuale të të drejtave të njeriut, nëse ka pasur fare, do të bëhet e dukshme vetëm atëherë kur të përfundojnë gjykimet.

3.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut

Në lidhje me monitorimin e rasteve të ndërlidhura me trazirat, pikëpamja e OmiK-ut është se këto shqetësime mund të paraqiten:

3.2.1 Perceptimi lidhur me animin e gjyqtarëve shqiptarë të Kosovës

Karakteret etnik të dhunës mund të bëjnë që shqetësimet të shtohen në radhët e komuniteteve të serbëve dhe ashkalinjëve të Kosovës për atë se gjyqtarët shqiptarë të Kosovës do të jenë subjektiv (të anshëm) në favor të shqiptarëve të Kosovës të akuzuar. OmiK-u është i brengosur lidhur me perceptimin e komunitetet të pakicave për sistemin e drejtësisë penale që dominohet nga shqiptarët e Kosovës. Mosbesimi mund t'i dekurajojë dëshmitarët nga komunitetet e pakicave që të raportojnë para policisë ose të dëshmojnë në gjykim për ato që kanë njohuri. Kjo në anën tjetër mund të rezultojë në mohim të drejtësisë për viktimat e krimeve.

Që nga fillimi, gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë u janë ndarë lëndët e krimeve të luftës dhe krimeve tjera me motive etnike, *në mes tjerash*, edhe për të mënjeluar mundësinë e perceptimit të animit nga ana e gjyqtarëve vendës. Mirëpo, gjyqtarët ndërkombëtarë nuk kanë kapacitete të merren me të gjitha rastet që ndërlidhen me trazirat dhe nuk do të kenë mundësi që gjithmonë të merren me rastet e ndieshme me elemente etnike. Përfundimisht, gjyqtarët vendës do të jenë ata të cilët do të tregojnë se ata mund t'i shqyrtojnë rastet në mënyrë të drejtë dhe objektive, dhe të ndërtojnë besimin përmes praktikës gjyqësore të mirë.

3.2.2 Mbrojtja e dëshmitarëve/ frikësimi

Mungesa e besimit në gjyqësi nga ana e pakicave si dhe në aftësinë e autoriteteve të UNMIK-ut për ofrimin e mbrojtjes efikase mund të nënkuptojë se dëshmitarët nga pakicat të frikohen nga represaljet për shkak të dhënjës së dëshmisë. Prap, edhe kjo mund të dekurajojë dëshmitarët që të dalin përpara.

Droja e këtyllë gjithashtu ekziston edhe në mesin e dëshmitarëve shqiptarë të Kosovës në lidhje me rastet e profilit të lartë të akuzimit të shqiptarëve të Kosovës, siç janë rastet e akuzimit të udhëheqësve të supozuar.

Në këtë drejtim, OmiK-u brengoset se policia, prokurorët dhe gjyqtarët ende nuk janë trajnuar në masë të mjaftueshme për shfrytëzimin e masave të mbrojtjes së dëshmitarëve.¹⁸

3.2.3 Presioni mbi gjyqtarët dhe prokurorët vendës

Për shkak të sensitivitetit të disa rasteve, kryesisht atyre kundër organizatorëve të supozuar të trazirave, ekziston mundësia që gjyqtarët dhe prokurorët vendës të vëhen nën presion të formës së kërcënimit dhe mitos. Kjo mund të ndikojë rëndë në administrimin e duhur të drejtësisë.

3.2.4 Aftësia e sistemit gjyqësor për t'u përballur me influksin e lëndëve

OmiK-u ka raportuar më heret lidhur me problemet që ndërlidhen me numrin e madh të lëndëve të pazgjdhura dhe mbi shpërndarjen joadekuatë të gjyqtarëve nëpër gjykata.¹⁹ Ky numër i rritur i lëndëve të pazgjdhura mund të prodhojë efekte në të gjithë sistemin, dhe standardet e gjykimit të drejtë mund të dëmtohen në përpjekje të redukimit të normës së lëndëve. Influksi i lëndëve që ndërlidhen me trazirat mund të vëjë edhe më shumë ngarkesë në resurset e gjyqësorit. Kjo është kështu veçanërisht duke pasur parasysh se gjykatat vetëm sa kanë filluar me zbatimin e Kodit të përkohshëm penal dhe Kodit të përkohshëm të procedurës penale²⁰ (si më poshtë).

3.2.5 Çështjet që kanë të bëjnë me paraburgimin

Numri i shtuar i personave të arrestuar për shkak të dhunës mund të rezultojë në shqetësimet që kanë të bëjnë me paraburgimin. Disa raste të paraburgimeve nga KFOR-i gjatë ose pas trazirave tanimë janë shënuar. Edhe pse OmiK-u mendon se në rrethana normale, paraburgimet e KFOR-it janë edhe të kundërligjshme por edhe të pajustificuara,²¹ sitata gjatë dhe pas trazirave ka qenë e atillë sa që mund të justifikohen paraburgimet e tilla duke pasur parasysh mandatin e KFOR-it siaps Rezolutës 1244 të KSKB, e cila e autorizon KFOR-in të të ofrojë mbrojtje dhe siguri në këtë hapësirë. Megjithatë, nëse nuk lirohen, atëherë të gjithë personat e burgosur nga KFOR-i duhet t'ju dorëzohen autoriteteve civile që në mundësinë e parë, kështu që kundër këtyre të mund të ngriten akuzat formale dhe që të mund të përfitojnë nga mundësia e rishqyrtimit gjyqësor të paraburgimit të tyre.

Githashtu mund të ngriten shqetësime edhe lidhur me gjykatat e rregullta të cilat nuk i përbahen afateve ligjore të parapara në ligjet penale për zgjatjen e paraburgimit. OmiK-u ka vërejtur se madje edhe në rrethana normale gjykatat nganjëherë dështojnë kur është fjala e arsyetimi adekuat me rastin e caktimit të paraburgimit. Me presionin e shtuar për shkak të influksit të lëndëve, gjykatat mund të mos e shqyrtojnë si duhet çështjen e paraburgimit dhe thjeshtë vetëm “ta vulosin” kërkesën e prokurorit.²²

¹⁸ Për më shumë hollësi lidhur me shqetësimet e OmiK-ut lidhur me sistemin e mbrojtjes së dëshmitarëve, lexoni raportin e OSBE-së “Shqyrtimi i sistemit penal-juridik (mars 2002 - prill 2003): Mbrojtja e dëshmitarëve në kuadër të sistemit penalo-juridik”.

¹⁹ Shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Seksionit për monitorim të sistemit juridik, Kosovë, “Administrimi i drejtësisë nëpër gjykatat komunale” i muajit mars 2004, f. 10 dhe raportin e nëntë nga i njëjti seksion mbi administrimin e drejtësisë të datës mars 2002, f. 10.

²⁰ Rregulloret e UNMIK-ut 2003/25 dhe 2003/26. Kodet kanë hyrë në fuqi me 6 prill 2004.

²¹ P.sh, shih raportin e OmiK-ut “Shqyrtimi i sistemit penal-juridik (mars 2002 - prill 2003): Mbrojtja e dëshmitarëve” faqet 33.

²² Për shembull, OSBE-Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës, Raporti javor (6 shkurt – 12 shkurt 2004).

3.2.6 Burgjet e stërmbushura

Stërmbushja e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit në Kosovë (me popullatën e burgjeve prej 1301 persona me 17 mars, sa për ilustrim, 151 më shumë se sa kapacitetet e burgjeve) ka qenë problematike edhe para shpërthimit të trazirave. Për këtë arsye, administrata e burgjeve mund të ketë probleme në gjetjen e vendeve për këtë numër të madh të të ndaluarave dhe burgosurve të rinjë. Mirëpo duhet të përmendet se shumica e të dyshuarve janë liruar për t'u mbrojtur në liri pas një kohe të shkurtër të mbajtjes në paraburgim.

3.2.7 Zbatimi i Kodit të Përkohshëm Penal dhe Kodit të Procedurës Penale

Hetimet të cilat inicohen pas hyrjes në fuqi të kodeve të reja penale²³ duhet të zhvillohen në bazë të Kodit të përkohshëm të procedurës penale. Këto kode sjellin me veti një sërë ndryshimesh të mëdha në mënyrën se si lëndët penale hetohen dhe gjykohen. Influksi i papritur i rasteve u'a bën gjyqtarëve edhe prokurorëve punën edhe më të vështirë për t'ju përshtatur regjimit të procedurës së re penale.

3.3 Veprimet e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe gjyqësisë vendëse

Që nga 6 maji rreth 135 raste të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me trazirat janë duke u ndjekur penalisht në gjykatat vendëse, përdërisa 48 raste²⁴ shqyrtohen nga prokurorët ndërkombëtar. Shumica e rasteve kanë të bëjnë me akuzat për plaçkitje, vjedhje dhe trazim të rendit dhe paqës publike, përdërisa një numër i vogël i veprave penale kanë të bëjnë me akuzat për vrasje, tentim vrasje dhe sulme kundër personave zyrtar. Gjithashtu disa persona të rëndësishëm janë arrestuar nën dyshimin se kanë ndihmuar të organizohen trazirat.

3.4 Aktivitetet përcjellëse

OMiK-u do të vëjë një prioritet në monitorimin e rasteve që kanë buruar nga shpërthimi i dhunës së marsit. OMiK-u do të përqëndrohet në monitorimin e rasteve që shqyrtohen nga gjyqësia vendëse mirëpo gjithashtu do të zhvillojë aktivitete përcjellëse rreth monitorimit të rasteve që shqyrtohen nga gjyqtarët ndërkombëtar. Krahas kësaj, gjithashtu do të monitorohet edhe problemi i stërmbushjes së burgjeve dhe qendrave të paraburgimit.

Në frymën e asaj që u përmend mësipër, OMiK-u do të identifikojë shkeljet e mundshme të të drejtës për gjykim të drejtë dhe problemet tjera të të drejtave të njeriut. OMiK-u është i mendimit se rastet e trazirave do të shërbejnë si një test për të konstatuar nëse gjyqësia vendëse është e gatshme për t'u marrë me raste sensitive që kanë dimension etnik.

²³ 6 prill 2004.

²⁴ Departamenti i Drejtësisë, raporti javor 30 prill – 6 maj 2004.

TË DREJTAT PRONËSORE

4.1. Hyrje

Ngjarjet e dhunshme të marsit kanë lënë pas veti rreth 700 shtëpi dhe ndërtesa fetare dhe publike të shkatërruara apo të dëmtuara dhe mëse 3,000 njerëz. Shumica e personave të zhvendosur nga shtëpitë e tyre ende janë në pamundësi të kthehen për shkak të problemeve të sigurisë, shkatërrimit të pronës apo okupimit të paligjshëm. Zhvendosja e detyruar e njerëzve dhe dëmtimi apo shkatërrimi i pronës paraqet dështim të organeve qeverisëse për të mbrojtur të drejtat e personave më të rrezikuar dhe një shkelje të vazhdueshme të të drejtës për pronë, të drejtës për shtëpi dhe të drejtës për banim adekuat. Në bazë të standardeve ndërkombëtare autoritetet kanë për detyrim të sigurojnë që mjetet juridike efikase për këto shkelje ekzistojnë dhe janë të qasshme për viktimat. Krahas kësaj, dhuna e marsit gjeneron detyrime positive për këto autoritete për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e personave të zhvendosur,²⁵ përfshirë këtu edhe të drejtën për t'u kthyer në shtëpi.

Shumica e sfidave të të drejtave të njeriut që kanë lindur si rezultat i dhunës së marsit janë të ngjashme me ato që kanë ekzistuar në Kosovë për shkak të situatës pas konfliktit dhe tranzicionit të sistemit politiko-ekonomik (me ndryshimet në pronësi dhe të drejtat pronëso- juridike). Si të tilla shumë rekomandime të cilat OMiK-u i ka artikulluar mëparë mbi çështjet siç janë okupimi i paligjshëm, rindërtimi dhe çështjet tjera lidhur me të drejtat pronësore mbeten të vlefshme. Disa nga to sidoqoftë kërkojnë një përqëndrim të veçantë në muajt e ardhshëm. Këto rekomandime nuk do të përsëriten në mënyrë të plotë këtu.²⁶

4.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut

Dhuna e marsit gjithashtu ka vënë në pah se dështimi i autoriteteve kompetente për të mbrojtur të drejtat e personave më të rrezikuar duket t'i ketë rrënjët në mangësitë ekzistuese në strukturat e dizajnuara për të parandaluar dhe përgjigjur shkeljeve të të drejtave pronëso- juridike. Ky dështim në të kundërtën ka kontribuar në ekzistimin e klimës së mosndëshkueshmërisë relative në lidhje me shkejlet e të drejtave pronëso- juridike.

Adresimi i mangësive është me rëndësi thelbësore në parandalimin e paraqitjes së shkeljeve të tilla në planin afatgjatë. Është me rëndësi thelbësore të sigurohet që njerëzit të kenë qasje të sigurtë fizike në shtëpitë dhe pronën e tyre që është e domosdoshme për kthimin e tyre. Në bazë të standardeve ndërkombëtare sigurimi i mjeteve juridike efikase për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut duhet të përfshijë edhe kompensimin sipas nevojës. Ofrimi i kompensimit zakonisht nuk kërkon vetëm kthimin e pronës së humbur²⁷ mirëpo gjithashtu

²⁵ Lexo Parimet udhëzuese të KB-ve mbi zhvendosjen e brendshme ("Parimet udhëzuese" dokumenti i KB-ve E/CN.4/1998/53/Add.2, i datës 11 shkurt 1998) ku parashikohen në mënyrë të detajuar të drejtat në fjalë.

²⁶ Lexo raportin e OSBE-së, *Të drejtat pronësore në Kosovë, 2002-2003* për të parë rekomandimet gjithëpërfshirëse.

²⁷ "Restitucioni" këtu shfrytëzohet për t'ju referuar kthimit/riposedimit të pronës së humbur mirëpo jo dhe pronës së konfiskuar nga shteti.

edhe masat e arsyeshme për të garantuar mospërsëritjen e këtyre shkeljeve²⁸ siç janë hetimet e incidenteve dhe ndjekja penale e personave përgjegjës.

4.2.1 Ndarja e banimeve të përkohshme për personat zhvendosur

OMiK-u është i brengosur që të drejtat e personave të zhvendosur për një standard adekuat të jetesës gjatë periudhës së zhvendosjes mund të neglizhohen përderisa çështjet me rëndësi më të madhe siç është rindërtimi janë në qendër të vëmendjes së IPVQ-ve dhe autoriteteve tjera gjegjëse.²⁹ Një numër i madh i personave të zhvendosur jetojnë në banime të përkohshme apo alternative për shkak se nuk kanë gjasa për kthim të menjëhershëm në shtëpitë e tyre. Mbrojtja e të drejtës së personave të zhvendosur për standard adekuat të jetesës ndërthen në veti edhe qasjen në strehim alternativ ose të përkohshëm i cili ka një standard minimal të kushteve sanitare dhe është i lidhur me infrastrukturën themelore.³⁰ Së këndejmi OMiK-u ka pranuar një sërë raportimesh të rasteve se personat e zhvendosur janë duke jetuar nën kushte të dobëta sanitare apo në ndërtesat e adaptuara në mënyrë joadekuate.³¹

OMiK-u gjithashtu është i brengosur se qasja e personave të zhvendosur në strehim alternative apo të përkohshëm pengohet nga përfshirja jo e qëndrueshme e zyrtarëve komunal përgjegjës për këtë proces si dhe nga mungesa e koordinimit në ndarjen e një strehimi të tillë. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, komunat janë përgjegjëse për sigurimin e banimeve sociale.³² Gjer më tani vetëm disa autoritete komunale kanë qenë të përfshira në gjetjen e strehimit për personat e zhvendosur përderisa të tjerët nuk kanë luajtur kurrfarë roli duke u'ar lënë vetë personave të zhvendosur apo agjencive tjera t'a zgjidhin këtë çështje.³³

Përderisa OMiK-u pranon faktin se disa komuna për momentin kanë resurse të kufizuara për të ofruar një strehim të tillë, komunat janë ende të obliguara që të koordinojnë dhe drejtojnë resurset në mënyrë të duhur për të ndihmuar në mbrojtjen e kësaj të drejte. Siç vërehet autoritetet komunale nuk duket se përmbushin një përgjegjësi të tillë në mënyrë të qëndrueshme. Në përgjithësi kjo rezulton në faktin se personat e zhvendosur pranojnë strehim në mënyrë *ad hoc* nëpërmjet të agjencive të ndryshme apo nuk pranojnë fare. Në bazë të informative të mbledhura nga OMiK-u më shumë se 1,000 persona të zhvendosur janë strehuar përkohësisht nga KFOR-i pas shpërthimit të dhunës përderisa të tjerët janë vendosur në strehimore të përkohshme të llojeve tjera (ndërtesa publike, kampe etj.) përderisa qindra të tjerë ishin strehuar në familje private nikoqire. Drejtori për çështje pronësore banesore (DÇPB) e ka për mandat mundësinë e lëshimit të lejeve të përkohshme të banimit për njerëz që kanë nevojë për ndihmë në banim të natyrës humanitare, dhe këtë e ka bërë për disa të që janë zhvendosur për shkak të dhunës së marsit³⁴. Përderisa OMiK-u kupton se komunat janë duke

²⁸ Dëmshtëpërblimi gjithashtu kërkon kompenzim dhe rehabilitim. "Studimi lidhur me të drejtën për dëmshtëpërblim, kompenzim dhe rehabilitim për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Raporti përfundimtar i dorëzuar nga zot. Theo van Boven, Raportuesi Special", E/CN.4/Sub.2/1993/8, 2 korrik 1993, faqe 56.

²⁹ Në bazë të Paktit ndërkombëtarë për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PNDJESK), veçanërisht neni 11, sikurse parimi 18 i Parimeve udhëzuese, autoritetet komunale dhe qëndrore duhet të ofrojnë, pa diskriminim, një standard minimal të ndihmës për personat e zhvendosur përfshirë këtu strehimin elementar, ushqimin, ujin, veshjen dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore.

³⁰ Komiteti mbi të drejtat ekonomike, social dhe kulturore, "Komenti i përgjithshëm 4": E drejta për banim adekuat⁷.

³¹ Në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, për shembull, 150 persona të zhvendosur përkohësisht janë të strehuar në një spital dhe dy shkolla të cilat siç raportohet kanë pajisje joadekuate të sanitacionit.

³² Neni 3.1(k). Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor mund të kenë përgjegjësi sa i përket ofrimit të strehimit të përkohshëm dhe/apo banimit social.

³³ "Bordi Koordinues për persona të zhvendosur" i themeluar në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica identifikoi disa probleme përkritazi me nevojat e menjëhershme të personave të zhvendosur. Kjo përfshinte edhe "lodhjen e nikoqirit" në situatat kur personat e zhvendosur janë vendosur në vendbanime private, mungesën e mbështetjes së IPVQ-ve për nevojat e personave të zhvendosur dhe nevojën për strehim adekuat të përkohshëm.

³⁴ Kjo për shembull ka ndodhë në Mitrovicë/Mitrovica.

u përballur me një gjendje emergjente, autoritetet komunale duhet të luajnë një rol udhëheqës koordinues për të siguruar që personat e zhvendosur në komunat e tyre të gëzojnë strehim të përkohshëm adekuat derisa të kthehen në shtëpitë e tyre apo të vendosin për të shkuar diku tjetër.³⁵

OMiK-u është gjithashtu i brengosur se nëse autoritetet dështojnë të adresojnë nevojat e strehimit të përkohshëm të personave të zhvendosur kjo do të inkurajojë personat e zhvendosur që të okupojnë në mënyrë të paligjshme banimet publike apo private (ku ekzistojnë kushte më të mira të jetesës), e cila së këndejmi do të përjetësojë ciklin e shkeljeve të të drejtave pronësoro-juridike (shih mëposhtë).

4.2.2 Rindërtimi

Rindërtimi paraqet një fushë tjetër në të cilën OMiK-u parasheh të përballet me sfidat e të drejtave të njeriut. Në një vendim të marrë më 20 mars dega e ekzekutivit të IPVQ-ve është zotuar të themelojë një fond për riparimin e pronës së dëmtuar gjatë incidenteve të dhunshme të cilat shpërthyen më 17 mars.³⁶ Gjer më tani, IPVQ-të nuk kanë kërkuar të lidhin ofrimin e ndihmës në rindërtim me kthimet individuale (apo, me fjalë tjera ata nuk kanë kërkuar që t'a bëjnë procesin një process i cili do të udhëhiqet nga kërkesa), mirëpo në vend të kësaj janë zotuar të rindërtojnë të gjitha shtëpitë e shkatërruara apo dëmtuara pavarësisht nga kërkesa, apo nga dëshira e bartësit të zhvendosur të drejtës pronësore për t'u kthyer.

OMiK-u vëren se përkundër vendimit politik për rindërtim, ky veprim si i vetëm nuk përmbush detyrimin që e kanë organet qeveritare për të krijuar kushtet për kthim të qëndrueshëm, siç është mjedisi i sigurtë apo qasja në punësim. Për më tepër, ky vendim politik nuk i obligon ata pronat e të cilëve janë rindërtuar të kthehen në shtëpitë e tyre. Të gjithë personave të zhvendosur nga shtëpitë dhe pronat e tyre duhet t'ju ofrohet një mundësi për të bërë një zgjidhje të informuar se a do të zgjedhin për të ushtruar të drejtën e tyre për kthim në shtëpitë e tyre. Pavarësisht se personi i zhvendosur a zgjedh të ushtrojë një të drejtë të tillë, autoritetet qeveritare duhet të ndërmarrin masa të arsyeshme për të siguruar që prona dhe të drejtat e tyre janë të mbrojtura³⁷.

Një shqetësim më thelbësor i OMiK-ut lidhur me ndihmën në rindërtim është e lidhur me procedurat për ndarjen dhe jetësimin e kësaj ndihme. Nga monitorimi i kaluar i proceseve të rindërtimit të zhvilluara në Kosovë, OMiK-u vëren se mungesa e procedurave transparente dhe të përkufizuara qartë shpesh rezulton në cenimet e të drejtave pronësore dhe të drejtave tjera sit ë përfituesve të kësaj ndihme ashtu edhe të palëve tjera të treat. Procedurat të cilat integrojnë dispozitat për mbrojtjen e të drejtave janë në harmoni me ligjin e zbatueshëm dhe përfshijnë në këtë edhe autoritetet e duhura janë treguar si mjaft të suksesshme në parandalimin e cenimeve të tilla.³⁸ Në kuadër të kontekstit në fjalë, një shqetësim i veçantë është sigurimi i qasjes së mjaftueshme të pakicave dhe pjesëmarrjes së tyre në procesin e rindërtimit, për shkak se kjo ndihmon në vlerësimin e drejtë për ndarjen e ndihmës në rindërtim. Përfaqësuesit e serbëve të Kosovës gjithashtu kanë shprehur dëshirën e tyre për t'u

³⁵ OMiK-u vëren se Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore gjithashtu ka një skemë të ofrimit të strehimit të përkohshëm humanitar e cila mund të shfrytëzohet.

³⁶ Vendimi i Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës i datës 20 mars 2004.

³⁷ Për shembull, nëse bartësi i të drejtës pronësore vendosë që të mos kthehet, organet qeveritare duhet të ndërmarrin masa të arsyeshme për ta parandaluar pengim-posedimin dhe vandalizimin dhe masa të arsyeshme për të siguruar se bartësi i të drejtës pronësore të ketë qasje të arsyeshme në gjykata dhe shërbime komunale siç është regjistri i patundshmërive me qëllim të disponojë ose ta lëshojë me qira pasurinë ose të kërkojë mbrojtje gjyqësore për shkeljet.

³⁸ Lexo raportin javor të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës të OSBE-së, 17-23 mars 2003; kapitulli 6, OSBE, *Të drejtat pronësore në Kosovë, 2002-2003* dhe *Vlerësimi i dhjetë i OSBE-së/UNHCR-së mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë*, mars 2003.

përfshirë në këtë proces.³⁹ Parimet udhëzuese të KB-ve mbi zhvendosjen e brendshme gjithashtu vëjnë në pah rëndësinë e pjesëmarrjes së personave të zhvendosur në këtë proces.⁴⁰

Vlerësimet e dëmeve të cilat janë kryer gjer më tani nga IPVQ-të sinjalizojnë se shqetësimet përkitazi me mungesën e përfshirjes së pakicave janë plotësisht të bazuara. Këto vlerësime janë kryer nga komisionet *ad hoc* në secilën komunë në të cilat është kryer dëmi dhe janë bërë sipas udhëzimeve të komisionit të veçantë qëndror ndërministror.⁴¹ Përderisa vlerësimet siç raportohet kanë pasur për qëllim të ofrojnë një vlerësim të përafërt të shpenzimeve për riparimin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara, informatat e mbledhura nga OMIK-u bëjnë me dije se ekziston një jokonsistencë anembanë Kosovës në mënyrën se si janë kryer këto vlerësime dhe se në shumë raste vlerësimet kanë dështuar të përfshijnë pjesëmarrjen e komuniteteve të prekura.⁴²

Përqëndrimi në sigurimin e qasjes efektive dhe pjesëmarrjes së pakicave si dhe mbrojtjen e fuqishme të të drejtave të tyre është me rëndësi thelbësore për fazën e tenderimit, ndarjes dhe implementimit të procesit të rindërtimit. Për shkak se OMIK-u ka cekur në raportet e tij paraprake,⁴³ se një model i fuqishëm dhe krijimi i një procesi të tillë të definuar mirë ekziston dhe është shfrytëzuar në mënyrë efektive për mëse dy vite—*Udhëzimet e UNMIK-ut për Banim dhe Rindërtim 2002* (Udhëzimet) të përpiluara nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor.⁴⁴ Dispozitat kryesore të këtyre udhëzimeve të cilat mund të merren parasysh për programin e rindërtimit të shtëpive të dëmtuara gjatë ngjarjeve të marsit janë ato që sigurojnë përfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, vërtetimin e të drejtave pronësoro-juridike dhe mekanizmat për shqyrtim dhe ankim.⁴⁵

Siç u cek më lartë, ndihma në rindërtim nuk plotëson si e vetme detyrimin e qeverisë kundrejt personave të zhvendosur, veçanërisht në rastet ku është përcaktuar se personat e zhvendosur janë në pamundësi për t'u kthyer. Kur kushtet janë të atilla ashtuqë kthimi është i përaulizueshëm në aspektin praktik apo i pamundshëm,⁴⁶ autoritetet përgjegjëse mund të kenë obligime shtesë për të ofruar ndihmë apo mundësisht edhe kompensim, në përpos apo në formë të ndihmës në rindërtim.⁴⁷ Mirëpo ekziston një rrezik se sigurimi i alternativave me para të gatshme për ndihmën në rindërtim mund të shfrytëzohet për qëllime politike për të inkurajuar migrimin ose zhvendosjen e përhershme në vend se të shërbejë thjeshtë si një formë e kompensimit. Për të minimizuar këtë rrezik, IPVQ-të dhe UNMIK-u duhet të sigurojnë se politikat e tyre pikësepari lehtësojnë dhe promovojnë të drejtën për kthim të atyre të cilët dëshirojnë t'a ushtrojnë mirëpo gjithashtu sigurojnë që për ata të cilët nuk dëshirojnë

³⁹ Gjatë javës së 3 majit (letra nuk ka datë), nënkryetarët shtesë të komunave të Fushës Kosovës/Kosovo Polje, Obiliqit/Obilić, Prishtinës/Priština dhe Lipjanit/Lipljan i dërguan një letër Kryeministrit ku kërkohet kyçja e përfaqësuesve serb në monitorimin e procesit të rindërtimit dhe kompanitë serbe të jenë kontraktorë.

⁴⁰ Parimet udhëzuese të KB-ve mbi zhvendosjen e brendshme, op. cit., Parimi 28.

⁴¹ Titulli i plotë i komisionit është "Komisioni ndërministror mbi menaxhimin e fondit buxhetor të qeverisë së Kosovës për riparimin e dëmeve."

⁴² OMIK-u ka mësuar se, për shembull, se më shumë se gjysma e vlerësimeve të dëmeve të kryera në nivel komunal nuk kanë pasur miratimin e përfaqësuesve të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të prekura nga dëmet. Kjo përfshin komunën e Prizrenit dhe Mitrovicës/Mitrovica të cilat kanë pësuar më së shumti dëme.

⁴³ Lexo raportet javore të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimit të së drejtës, të OSBE-së 16-22 prill 2004 dhe 17-23 mars 2003, *Të Drejtat pronësore në Kosovë 2002-2003*, qershor 2003, dhe *Vlerësimi i dhjetë i përbashkët OSBE/UNHCR-së mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë*, mars 2003.

⁴⁴ Zbatueshmëria e tanishme e udhëzimeve, megjithatë mbetet e paqartë. Udhëzimet janë publikuar në vitin 2002 dhe zgjeruar për shfrytëzim gjatë vitit 2003 nëpërmjet të një vendimi ekzekutiv. OMIK-u nuk ka dijeni për zgjerimin e udhëzimeve për shfrytëzim të tyre gjatë vitit 2004 apo për programin e tanishëm të rindërtimit (prona e djegur apo dëmtuar gjatë ngjarjeve të mesit të marsit).

⁴⁵ Disa dispozita siç janë kriteret për zgjedhjen e përfutuesve dhe procedurat plotësuese mund të mos jenë në pajtim me procesin e rindërtimit në periudhën pas marsit.

⁴⁶ Për shembull nëse situata e sigurisë parandalon kthimin për një periudhë të qëndrueshme kohore, apo kthimi i të drejtave pronësoro-juridike është i përaulizueshëm në aspektin praktik apo i pamundur, kushtet mund të jenë të atilla ashtuqë një person nuk ka mundësi të kthehet.

⁴⁷ Parimi 29.2 i Parimeve udhëzuese të KB-ve mbi zhvendosjen e brendshme.

t'a ushtrojnë, se të drejtat e tyre siç është e drejta për t'a shitur pronën e vet në mënyrë të lirë dhe e drejta për të pranuar dëmshpërblim të duhur, respektohen dhe mbrohen.

4.2.3 Okupimet e reja të kundërligjshme

Adresimi i çështjes së okupimit të paligjshëm është gjithashtu pjesë e një ndihme të gjerë e cila shërben për të lehtësuar kthimin dhe për të siguruar dëmshpërblimin e duhur. Në përgjithësi, okupimi i paligjshëm i pronës banesore dhe asaj jo banesore njihet në mënyrë të gjerë si një problem i vazhdueshëm dhe mjaft i përhapur anembanë Kosovës, problem ky i cili paraqet në pengesë për kthimin i cili ndërlihet me konfliktin e vitit 1999 dhe është duke penguar zhvillimin ekonomik të Kosovës.⁴⁸ Menjëherë pas dhunës së marsit disa prona të shkatërruara pjesërisht dhe të braktisura me dhunë ishin okupuar në mënyrë të paligjshme apo riokupuar në mënyrë të paligjshme, përderisa shumë prona të tjera ishin lënë pre e okupimit të paligjshëm kur banorët e tyre kishin ikur.⁴⁹

Për shembull, në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, 24 banesa të shqiptarëve të Kosovës në Mitrovicën veriore janë okupuar në mënyrë të paligjshme nga serbët e Kosovës. Në komunën e Obiliqit/Obilić prona e cila i takon një serbi të Kosovës është okupuar në mënyrë të paligjshme nga një shqiptar i Kosovës. DÇPBP-ja është në proces të vendosjes së pronës nën administrimin e vet.⁵⁰ Në vendet tjera siç është Svinjare/Svinjarë në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica individët kanë shkruar me sprej emrat e tyre në pronat e braktisura.

Shqetësimi kryesor lidhur me të drejtat e njeriut

Në përgjithësi, sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ligjit të zbatueshëm, autoritetet duhet të ndërmarrin masa të arsyeshme për të mbrojtur ose parandaluar shkeljen e sërishme të të drejtave pronësore të pronarëve të zhvendosur, përfshirë këtu edhe dëmtimin apo pengim posedimin e pronave të tyre.⁵¹ Më heret, OmiK-u i ka artikuluar shqetësimet lidhur me mbrojtjen joadekuatë kundër okupimeve të kundërligjshme në Kosovë, shumica prej të cilave në këtë kontekst janë relevante⁵². Menjëherë pas dhunës së marsit janë dy shqetësime të cilat janë paraqitur.

Roli i DÇPBP-së dhe gjykatave

Para dhunës së marsit, ekzistonte një huti në lidhje me kompetencat e Drejtoratit për çështje pronësore dhe banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore (KKPB-së) mbi okupimet e paligjshme në lidhje me pronën banesore të braktisur.⁵³ Tani edhe më shumë huti mund të krijohet pas dhunës së marsit. Drejtoratit për çështje pronësore dhe banesore është në

⁴⁸ Lexo hyrjen dhe kapitullin 2, OSBE, *Të drejtat pronësore në Kosovë, 2002-2003*, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 mbi themelimin e Drejtoratit për çështje pronësore dhe banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore, 15 nëntor 1999. Lexo gjithashtu raportin javor të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimit të ligjit pranë OSBE-së, 12-18 dhjetor 2003 mbi okupimin e paligjshëm të tokës komerciale dhe bujqësore.

⁴⁹ Një riokupim i tillë i referohet pronave të cilat u janë kthyer poseduesve të tyre të ligjshëm, të cilët mëpastaj i kanë braktisur ato gjatë dhunës së 17-19 marsit duke lënë kështu pronat e tyre përsëri të rrezikuara nga okupimi i paligjshëm.

⁵⁰ OmiK-u është duke hetuar dy raste të okupimit të mundshëm të paligjshëm në komunën e Lipjanit/Lipljan.

⁵¹ Lexo parimin 21, Parimet udhëzuese të KB-ve mbi zhvendosjen e brendshme. Gjithashtu lexo praktikën gjyqësore të rasteve të mjetëve të efektshme juridike (neni 13, i KEDNj) dhe për të drejtat pronësore sikur *Airey kundër Irlandës*, 628/73, 10 shtator 1979, para, 32; *Blentic kundër R.S.*, CH/96/17, 5 nëntor 1997, para 26-32; *Mantovic kundër R.S.* CH/96/1. 11 korrik 1997 para, 56. Gjithashtu neni 2 i Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike. Ligji specifik për Kosovën, shih paragrafin 11 (j) të RKS të KB 1244; nenin 2 të Rreg UNMIK 1999/1 mbi autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë dhe kreun 2 dhe 3.2 të Reg të UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuse për Vetëqeverisjen në Kosovë.

⁵² Shih publikimet relevante të OmiK-ut të përmendura në futnotat...

⁵³ Veçanërisht, ekziston një huti ose mungesë e qartësisë përkritazi me atë se cilit subjekt parashtruesit e mundshëm të kërkesës pranë KKPB-së të cilët nuk i'u kanë përmbajtur afatit duhet t'i parashtrorjnë kërkesë pas skadimit të afatit për parashtrim të kërkesave pranë KKPB-së 1 korrik 2003. Lexo raportin javor të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës, 26 maj – 1 qershor 2003 për diskutime më të hollësishme.

gjendje t'i vendos këto prona të braktisura nën administrimin e vet.⁵⁴ Masat e tilla nga DÇPB-ja mund të jenë mjaft efikase në mbrojtjen e këtyre pronave dhe parandalimin e shkeljeve të mëtutjeshme të të drejtave të personave të zhvendosur. Megjithatë, aktivitetet e DÇPB-së mund të shkaktojnë huti tek gjykatat e rregullta në lidhje me kompetencat e tyre dhe KKPB-së mbi kërkesat e ngjashme për shkak se këto aktivitete mund t'ju bëjnë përshtypje gjykatave se KKPB mund të jetë kompetente për këto lëndë. Për momentin, KKPB-ja nuk ka jurisdikcion të shqyrtojë kërkesat në lidhje me pronat e sapo okupuara në mënyrë të kundërligjshme përpos nëse është parashtruar paraprakisht ndonjë kërkesë në lidhje me pronën në fjalë. Gjykatat e rregullta kanë jurisdikcion mbi këto kërkesa për shkak se okupimi i paligjshëm dhe dëmtimi i pronës paraqesin shkelje të kodit civil dhe penal.

Policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës

Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja gjithashtu luajnë një rol parandalues dhe korrigjues në mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe të drejtave të ndërlidhura me pronën të personave të zhvendosur. Ata kanë autoritet të arrestojnë penguesit e posedimit dhe okupuesit e paligjshëm si dhe të mbështesin ekzekutimin e urdhërave për dëbim kur një gjë e tillë kërkohet. Në bazë të informatave që OMiK-u i ka pranuar, policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja nuk janë domosdoshmërisht duke e përdorur pushtetin e tyre në mënyrë të plotë për të mbrojtur të drejtat pronësore, mirëpo në vend të kësaj përqëndrojnë aktivitetet e tyre në lidhje me pronën në ekzekutimin e urdhërave të lëshuar nga DÇPB-ja dhe KKPB-ja.⁵⁵ Për t'i ndihmuar policisë në mbrojtjen e të drejtave pronësore, OMiK-u sugjeron trajnim shtesë (dhe udhëzim mbi politikat gjegjëse) për policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në mbi kompetencat e tyre në lidhje me pengim posedimin, okupimin e paligjshëm dhe procedurat pas dëbimit.

4.3 Aktivitetet përcjellëse

OMiK-u do të vazhdojë të monitorojë, analizojë dhe këshillojë mbi ndarjen e strehimit të përkohshëm, procesin e rindërtimit dhe zgjidhjen e okupimit të paligjshëm të cilat kanë lindur si rezultat i dhunës së marsit. OMiK-u gjithashtu do të përqëndrohet në mënyrë më strategjike në adresimin e kulturës së mosndëshkueshmërisë për ata që shkelin të drejtat pronësoro-juridike.

OMiK-u do të avokojë për një vetëdijësim më të madh të opinionit publik në lidhje me pasojat e të drejtave të pasigurta pronësore, një përgjegjshmëri të shtuar të autoriteteve për dështimet e tyre aktive dhe pasive në mbrojtjen e të drejtave pronësore, zbatimin efikas të mbrojtjes ligjore të të drejtave pronësore dhe fuqizimi i ligjeve dhe institucioneve që kanë të bëjnë me pronën.

⁵⁴ Lexo nenin 1.1, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23, dhe neni 12 I Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore banesore dhe Rregullat e procedurës dhe dëshmive të Drejtoratit për çështje pronësore dhe banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhebanesore, 31 tetor 2000.

⁵⁵ Për shembull, në komunën e Pejës/Peç, një okupues i paligjshëm theu urdhërin e DÇPB-së duke riokupuar pronën në mënyrë të paligjshme. Pas kërkesës së pronarit të ligjshëm i cili ishte kthyer, okupuesi i paligjshëm ishte larguar nga ajo pronë. Ai, megjithatë nuk ishte akuzuar për pengim posedimi apo arrestuar. Në rajonet tjera, OMiK-u kishte pranuar ankesë se përkundër faktit se policia ishte bërë me dije për pengim posedimin ata nuk kishin vepruar fare.

MOSDISKRIMINIMI

5.1. Hyrje

Pas shpërthimit të dhunës kundër komuniteteve të pakicave gjatë ngjarjeve të marsit, qasja në shërbimet elementare dhe institucione (siç janë kujdesi shëndetësor, arsimi, mirëqenia sociale, shërbimet publike) për komunitetet e pakicave (veçanërisht personat e zhvendosur) është edhe më e kufizuar për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes. Më tutje, qasja e nëpunësve civil serbë në vendet e tyre të punës duket mjaft e vështirë për shkak të zhvendosjes së tyre dhe problemeve të shtuara të sigurisë. Së fundi, pas ngjarjeve të marsit, përdorimi i gjuhëve zyrtare nga zyrtarët public dhe ndarja e buxhetit komunal komuniteteve të pakicave dhe skema⁵⁶ e financimit të barabartë komunal duket të jetë me rëndësi edhe më jetike me qëllim të lehtësimit të procesit të integritit të komuniteteve të pakicave në jetën publike.

Në periudhën menjëherë pas shpërthimit të dhunës së marsit, ofrimi i shërbimeve elementare (siç është arsimi, kujdesi shëndetësor) komuniteteve të prekura të pakicave është duke u adresuar nëpërmjet të strukturave ekzistuese paralele.⁵⁷ Në këtë kontekst, është me rëndësi të veçantë që si autoritetet përgjegjëse komunale gjithashtu edhe ato qëndrore t'i përgjigjen nevojave të grupeve të rrezikuara në pajtim me detyrimet e tyre positive siç parashihen me ligjin e zbatueshëm. Çdo qasje e ndryshme mund të rezultojë në sforcimin e strukturave paralele ekzistuese apo në themelimin e strukturave të reja.

Shembujt e mëposhtëm nuk duket të jenë të shtershëm mirëpo më shumë shërbejnë si ilustrim për sfidat e përgjithshme të të drejtave të njeriut të cilat OMiK-u i ka identifikuar në fushën e mosdiskriminimit pas ngjarjeve të marsit.

5.2 Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut

5.2.1 Qasja në shkollimin fillor dhe të mesëm për nxënësit nga komunitetet e pakicave

OMiK-u është i brengosur përkitazi me mungesën e qasjes në arsim për nxënësit e zhvendosur që vijnë nga rradhët e pakicave. Pas ngjarjeve të fundit, disa shkolla janë djegur, dëmtuar apo disa madje shërbejnë si strehimore për personat e zhvendosur⁵⁸ që e bëjnë qasjen fizike të nxënësve të pakicave në shkolla edhe më të vështirë, veçanërisht të atyre që janë të zhvendosur. Për shembull, shumica e shkollave në rajonin e Prishtinës/Priştina janë duke punuar për të strehuar prej (në Prishtinë/Priştina) deri në 300 (në Fushë Kosovë/Kosovo Polje) nxënës shtesë pas ngjarjeve të marsit. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovicës pas shkatërrimit të fshatit Svinjare/Svinjarë, shkollat në veriun e Mitrovicës/Mitrovicës duhet të akomodojnë një numër më të madh të nxënësve të zhvendosur. Në disa raste kjo ka krijuar një nevojë të madhe për hapësirë⁵⁹ dhe materiale shtesë.

⁵⁶ Lexo nenet prej 4.4 - 4.8 të Rregullores 2003/41 të UNMIK-ut mbi miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 1 janar deri 31 dhjetor 2004 dhe udhëzimet administrative 2004/01 mbi administrimin e financimit të barabartë nga komunat.

⁵⁷ Lexo raportin e Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës, mbi strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003.

⁵⁸ Shkolla në Šilovo/Šillovë është duke u shfrytëzuar si strehimore e përkohshme për personat e zhvendosur nga qyteti i Gjilanit/Gnjilane. Për këtë arsye objekti ka kapacitet të kufizuar për të organizuar klasat mësimore.

⁵⁹ Në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, 13 nxënës rom të shkollës fillore dhe rreth 40 nxënës të tjerë rom të mësimt shtesë të cilët kishin ndjekur mësimet në shkollën Sveti Sava nuk kanë qasje në shkollën e cila gjendet në Uglar/Ugljarë për shkak të mungesës së hapësirës. Duket se nxënësit që kanë mbetur mbrapa me mësim do të mund të vendoseshin në shkollën e Kuzminit.

Për më tepër, mosdisponibiliteti i transportit për në shkolla i nxënësve të zhvendosur dhe të komuniteteve tjera pakica dhe mungesa e përcjelljeve të sigurisë ka ndikim të madh në mundësinë e këtyre nxënësve për t'i ndjekur mësimet.⁶⁰ Për shembull, në komunën e Vushtrisë/Vučitrn qasja në shkollimin e mesëm nga ana e nxënësve minoritar është mjaft problematike për shkak të mungesës së transportit me përcjellje për në veri të Mitrovica/Mitrovicës, i cili në disa raste ende nuk është rivendosur.

Krahas kësaj, si rezultat i ngjarjeve të marsit, shumë shkolla të përziera mbesin ende të mbyllura. Për shembull në Viti/Vitina, gjer më tani, komuna, prindërit serb, mësimdhënësit dhe drejtori i shkollës serbe nuk kanë mundur të arrijnë një marrëveshje përkitazi me të ardhmen e shkollës së përzier në Mogila, e cila ende mbetet e mbyllur. Serbët e Kosovës të cilët nuk dëshirojnë që fëmijët e tyre t'i ndjekin mësimet në shkollën e përzier dhe kërkojnë formimin e një sistemi të ndërrimeve në mënyrë që fëmijët serbë të ndahen nga ata shqiptarë. Kurrfarë marrëveshje nuk është arritur në lidhje me këtë çështje.

5.2.2 Qasja në mirëqenien sociale për komunitetet e pakicave

OMiK-u është i brengosur që mungesa e lirisë së lëvizjes ndërhyt në aftësinë e pjesëtarëve të komuniteteve pakica për t'ju qasur shërbimeve sociale elementare, veçanërisht kur kemi të bëjmë me skemën e ndihmës sociale. Kjo situatë ngrit edhe më tepër shqetësime përkitazi me afërsinë e qasjes së QPS-ve për të arritur deri tek komunitetet pakica sa i përket ofrimit të ndihmës dhe mbrojtjes sociale.⁶¹ Gjithashtu duket se oficerët e komuniteteve lokale të UNMIK-ut (OKL) pas ngjarjeve në fjalë filluan të luajnë një rol thelbësor në shpërndarjen e fondit të ndihmës sociale për pjesëtarët e komuniteteve pakica. Kjo situatë paraqet një dështim i përket qëndrueshmërisë së procesit të sipërpërmendur.

5.2.3 Qasja në kujdesin shëndetësor për të zhvendosurit dhe komunitetet e pakicave që kanë mbetur në lokalitetet e prekura nga ngjarjet e marsit

OMiK-u është i brengosur se qasja në kujdesin shëndetësor nga ana e pjesëtarëve të pakicave është e ndikuar kryesisht nga ngjarjet e marsit. Ky problem është edhe më i theksuar kur kemi të bëjmë me qasjen në kujdesin shëndetësor sekondar. Qasja në kujdesin shëndetësor pengohet qoftë për shkak të mungesës së transportit të sigurtë për në objektet shëndetësore apo për shkak se objekti përkatës është djegur⁶² ose dëmtuar seriozisht. Për shembull në komunat e Gjilanit/Gnjilane dhe Vitisë/Vitina, komunitetet e pakicave mund të shfrytëzojnë vetëm ato ambulanta të cilat gjenden në enklavat serbe. Komuniteti rom në Gjilan/Gnjilane nuk ndihet mirë që të shfrytëzojë spitalin e Gjilanit/Gnjilane dhe preferon të udhëtojë në Šilovo/Shillovë për të kërkuar shërbime mjekësore.

Nuk sigurohet ndonjë transport për ambulancat që ndodhen në enklavat serbe në rast të ndonjë situatë emergjente dhe nuk ekziston ndonjë system i referimit.

⁶⁰ Në qytetin e Lipjanit/Lipljan para dhunës së marsit nxënësit serbë që jetojnë në jug të Lipjanit/Lipljan shkonin për në shkollë duke ecur nëpër oborret e shtëpive serbe. Këto shtëpi megjithatë janë djegur dhe tani nxënësit serbë mendojnë se nuk është e sigurtë për të kaluar andejpari. Ekziston një pikë kontrolluese statike e cila është vendosur jashtë shkollës fillore mirëpo kurrfarë përcjellje nuk është organizuar për nxënësit të cilët ende kanë probleme për të udhëtuar në shkollë.

⁶¹ Në komunën e Vitisë/Vitina ekziston vetëm një zyre e QPS-së e cila është e vendosur në qytetin e Vitisë/Vitina. Për shkak të lirisë së kufizuar të lirisë, qasja në këtë QPS është mjaft e kufizuar për serbët, romët dhe kroatët e Kosovës që jetojnë në komunën e Vitisë/Vitina, veçanërisht pas ngjarjeve të marsit. Situata është e ngjashme në nënzyrën e QPS-së të vendosur në Gornje Kusce/Kuscë i Epërm (komuna e Gjilanit/Gnjilane). Nënzyrja funksionion pjesërisht, mirëpo për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes, për momentin nuk është e qasshme për pjesëtarët e komuniteteve të pakicave që jetojnë fshatrat tjerë të komunës. Komunat e Mitrovica/Mitrovicës (pjesa veriore) dhe ajo e Zveçanit/Zvečan Kano pranuar një numër mjaft të madh të personave të zhvendosur. Nevojat e këtij numri shtesë të personave të zhvendosur sa i përket shërbimeve të ndihmës dhe mbrojtjes sociale duhet të adresohen.

⁶² Për shembull, pasi që spitali në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ishte djegur për shkak të ngjarjeve të marsit, serbët dhe romët në rajonin e Prishtinës/Priština kanë opsione të kufizuara sa i përket pranimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor sekondar. Të vetmet objekte shëndetësore që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor sekondar janë të vendosura në Graçanicë/Gračanica, Laplje Selo/ Llapje Sellë dhe Mitrovicën veriore.

5.2.4 Qasja në vendet e punës për komunitetet e pakicave

OMiK-u është i brengosur se pjesëtarët e komuniteteve pakicë të punësuar në administratën civile të Kosovës në disa komuna nuk kanë filluar të punojnë sërish pas ngjarjeve të marsit.⁶³ Për shembull, serbët e Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe Obiliqit/Obilić të cilët kanë punuar në ndërtesën komunale nuk janë kthyer ende në punë. Në Gjilan/Gnjilane, shumica e nëpunësve civil serbë ende nuk shkojnë në punë në ndërtesën komunale e cila gjendet në qytet për shkaqe sigurie. Nuk është nxjerrë ndonjë politikë e qartë përkitazi me pasojat e mos shkuarjes në punë të të punësuarve serb për kontratat e tyre të punës.

OMiK-u është gjithashtu i brengosur se zhvendosja e të punësuarve minoritar të QPS-ve dhe vështirësitë me të cilat përballen ata në qasjen e vendeve të tyre të punës e cila ndikon në mundësinë e tyre për të ofruar shërbime pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave.⁶⁴

5.2.5 Qasja në shërbimet publike për komunitetet e pakicave

OMiK-u është i brengosur për qasjen e personave të zhvendosur në shërbimet publike (siç është rryma, uji, gazi etj). Sipas informatave të mbledhura gjer më tani, duket se ekziston huti rreth rolit të komunave në sigurimin që shërbimet e tilla u ofrohen personave të zhvendosur apo ish personave të zhvendosur të cilët kthehen në vendet e tyre.⁶⁵ Komunitat kanë nevojë për të marrë përgjegjësitë e tyre⁶⁶ për të siguruar që personat e zhvendosur kanë qasje në shërbimet publike dhe gëzojnë të drejtën për standard adekuat të jetesës.

5.2.6 Mosrespektimi i standardeve për përdorimin e gjuhëve zyrtare nga ana e autoriteteve komunale dhe qëndrore

Çështja e cila ka të bëjë me përdorimin e gjuhës amtare në sferën publike vazhdon të jetë një pengesë e rëndësishme në mundësinë e pakicave për t'ju qasur shërbimeve elementare. Kjo çështje është adresuar nga një ekip i posaçëm i punës⁶⁷ mbi "Plotësimin e standardeve gjuhësore" i cili ekip kohëve të fundit ka publikuar një raport përfundimtar me përfundime dhe rekomandime.

5.2.7 Ndarja e drejtë e granteve për komunitetet e pakicave përmes financimit të barabartë komunal

OMiK-u vëren se pas ngjarjeve të mesit të marsit, praktikat komunale në ndarjen e granteve për komunitetet pakicë dhe financimin e barabartë komunal janë bërë edhe më me rëndësi kritike. Është me rëndësi të madhe që komunitetet pakicë të luajnë një rol aktiv në këtë proces.

⁶³ Në rastet ku lokalet e Zyreve Komunale të Komuniteteve (ZKK-ve) kanë qenë të ndara nga lokalet e komunës ata kanë vazhduar të punojnë (me disa përjashtime ku të punësuarit kanë qenë të zhvendosur në lokacionet tjera). Për shembull, të gjithë të punësuarit serbë në Prishtinë/Priştina janë duke punuar në Gračanica/Gračanicë; anëtarët serb të stafit të ZKK-së në Lipjan/Lipljan janë vendosur në ndërtesa të veçanta (një në qytet dhe një zyre satelit në Donja Gušterica/ Gushterica e Ultë) ku ata vazhdojnë të punojnë.

⁶⁴ Për shembull në komunën e Gjilanit/Gnjilane, nënzyrja e QPS-së e cila është caktuar që të punojë me komunitetet e pakicave në Gornje Kusce/Kuscë i Epërm është e hapur, mirëpo nuk funksionon plotësisht për shkak të mungesës së transportimit të sigurtë të stafit serb për në vendet e tyre të punës në atë zyre.

⁶⁵ Për shembull, në Obiliq/Obilić personat e zhvendosur për momentin janë duke jetuar nëpër kontejnerë. Organizata ndërkombëtare joqeveritare GOAL është pajtuar që të ndihmojë në adaptimin e kontejnerëve që t'i bëjë ata më të mirë për të jetuar në to has (p.sh duke vendosur dritare). Organizata në fjalë nuk ka bërë ndonjë premtim për të siguruar fonde për ndonjë shërbim komunal. Megjithatë nënkryetari tjetër në komunën e Obiliqit/Obilić deklaroi se beson që GOAL do të sigurojë një financim të tillë. Serbët e Kosovës të zhvendosur nga Belo Polje, në rajonin e Pejës/Peć, kishin qenë në gjendje të kthehen dhe kishin ndërtuar shtëpitë më 22 prill mirëpo KFOR-i ende siguron rrymën dhe ujin për ta.

⁶⁶ Lexo nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë.

⁶⁷ I kryesuar nga Zyra për çështje të komuniteteve (shtylla II e administratës civile), ekipi i punës përbëhej nga përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Shërbimeve Publike, OMiK-u, Zyra për kthim dhe komunitete, Administrata dhe drejtoratet regjionale dhe komunale të UNMIK-ut.

Për më tepër duket se disa zyrtarë komunal të komuniteteve filluan të kërkojnë një buxhet të posaçëm nga ai komunal. Nuk është pruar ndonjë politikë sa i përket zyrtarëve komunal të komuniteteve dhe kërkesës së tyre për një ndarje të buxhetit.⁶⁸

5.3 Veprimet e ndërmarra nga UNMIK-u/IPVQ-të për adresimin e shqetësimeve

5.3.1 Qasja në vendet e punës për komunitetet e pakicave

Komunikimi ndërmjet organeve komunale dhe të punësuarve serbë të shërbimit civil është duke u zhvilluar kryesisht nëpërmjet të përfaqësuesve të UNMIK-ut në shumicën e komunave të rajonit të Prishtinës/Priština, komuna këto të prekura më së shumti nga ngjarjet e mesit të marsit.

Që nga mesi i marsit, ZKK luajtën një rol proaktiv⁶⁹ në përpjekjet e tyre për të lehtësuar dialogun ndërmjet autoriteteve komunale dhe zyrtarëve për arsimim të serbëve të zhvendosur përkohësisht.

Në Obiliq/Obilič, drejtori i QPS-së lehtësoi kthimin në punë të një të punësuarit serb të QPS-së duke e ristrehuar atë në një zyre në kampin e Plemetit/Plemetina (në lokalet e UNHCR-së).

Në komunën e Gjilanit/Gnjilane administrata komunale për momentin është duke diskutuar çështjen e transportit të mësuesve që vijnë nga rradhët e pakicave për në vendet e tyre të punës nëpërmjet të UNMIK-ut i cili do të lehtësojë një dialog të tillë.

Gjithashtu në Gjilan/Gnjilane, UNMIK-u është duke u përpjekur të lehtësojë procesin e kthimit të nëpunësve civil serbë për në vendet e tyre të punës në komunë. Megjithatë as administrata komunale dhe as të punësuarit serb nuk kanë ndërmarrë hapa konkret për të zgjidhur këtë situatë.

5.3.2 Mosrespektimi i standardeve për përdorimin e gjuhëve zyrtare nga ana e autoriteteve qëndrore dhe komunale

Që nga ngjarjet e vesit të marsit nuk është identifikuar ndonjë përpjekje e rëndësishme në përmirësimin e gjendjes në këtë fushë. Megjithatë duhet të ceket se Ekipi i Punës i sipërpërmendur ka nxjerrur disa përfundime dhe rekomandime të cilat sugjerojnë domosdoshmërinë për adresimin e kësaj çështje. Ekipi i punës gjithashtu rekomandoi formulimin e udhëzimit administrativ mbi përdorimin e gjuhëve nga Ministria e Shërbimeve Publike dhe ndarja e menjëhershme⁷⁰ për të ofruar shërbimet e nevojshme gjuhësore.

⁶⁸ Si shembull, OKK-ja në Fushë Kosovë/Kosovo Polje kishte bërë një kërkesë formale asistentit të Zyrës së komuniteteve lokale duke kërkuar që OKK-ja të ketë një hapësirë të veçantë për zyre dhe të fillojë të veprojë me një buxhet të posaçëm. Për më tepër, kryesuesit e zyreve të komuniteteve lokale të komunave të Lipjanit/Lipljan dhe Obiliqit/Obilič deklaruan se zyret e tyre duhet të kenë buxhete të ndara.

⁶⁹ Asistenti i OKK-së i komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje ftoi UNHCR-në, ORC-në dhe OMik-un që të vizitojnë tre drejtorë të shkollave (ku që të gjithë prej tyre për momentin janë duke punuar në të njëjtën ndërtesë në Ugljare/ Uglar) dhe ish zëvendës drejtorin e arsimit të komunës. Megjithatë askush nga komuna, OKK-ja apo departamenti i arsimit nuk ishin të pranishëm. Gjithashtu, OKK-ja në Lipjan/Lipljan kishte udhëtuar deri në shkollat gjegjëse në komunë për t'i vizituar dhe ofruar mbështetje stafit të atyre shkollave.

⁷⁰ Shpenzimet për shërbime gjuhësore do të lirohen nga suficiti i vitit 2003 i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) dhe e cila në një fazë të mëvonshme do të bëhet një pjesë përbërëse e BKK-së.

5.4 Aktivitetet përcjellëse

OMiK-u do të vazhdojë të monitorojë të gjitha sfidat e sipërpërmendura të të drejtave të njeriut dhe do të këshillojë dhe jap rekomandime konkrete autoriteteve të përfshira të UNMIK-ut/IPVQ-ve.

Diskutimet gjatë tërë këtij procesi, veçanërisht në nivel komunal do të jenë me rëndësi qenësore për zhvillimin e aktiviteteve përcjellëse lidhur me zotimet e dhëna nga autoritetet përgjegjëse.

OMiK-u gjithashtu do të përcjellë zhvillimet e ardhshme në procesin legjislativ sa i përket nxjerrjes së ligjit kundër diskriminimit⁷¹. Shpallja e këtij ligji do të jetë jetike për ofrimin e mjeteve juridike për shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut në fushat e sipërpërmendura.

⁷¹ Ligji kundër diskriminimit, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004. Ky ligj ende nuk ka hyrë në fuqi. Ky ligj në gjenezën e vet e ka pasur modelin e një pakoje të ligjit kundër diskriminimit (omnibus legjisacion) i cili është hartuar nga OmiKu dhe i është dorëzuar IPVQ për ta shqyrtuar në shtator të vitit 2002. OmiKu ka avokuar fuqimisht për shpalljen e këtij ligji që nga fillim i vitit 2002 dhe IPVQ-ve u ka ofruar në vazhdimësi këshilla juridike gjatë procesit të përgatitjes së tij.